



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.4.2023

Nr: 268

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË DISA
INSTITUCIONEVE, PËR PERIUdhËN 10 MARS – 16 MARS 2023**

Sot, më datë 5.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural-AZHBR, Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve, Prefekti i Qarkut Dibër, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, Bashkia Korçë, Bashkia Bulqizë, Bashkia Kuçovë, Bashkia Mat, Bashkia Pukë.

OBJEKTI: Vlerësim i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 10 mars deri më 16 mars 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Data: 5.4.2023 Nr: 268
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 10 Mars – 16 Mars 2023”

Gjatë periudhës 10 mars deri më 16 mars 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike, janë raportuar gjithsej 254 aktivitete, nga 58 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se nga këto, 32 aktivitete të zhvilluara nga 13 institucione janë raportuar në tejkallim të afatit ligjor. Më datë 17.3.2023, administrata e KQZ-së i ka kërkuar institucioneve nëpërmjet email-it, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve, si dhe të drejtën e tyre për t'u paraqitur në seancën publike të datës 24.3.2023, ora 11:00. Palët e interesuara depozituan pranë KQZ-së pretendimet e tyre si vijon:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet *"Inagurim i Spitalit të Sëmundjeve të Brendshme"*, raportuar më datë 15.3.2023 dhe datë zhvillimi 18.3.2023.
 - Aktivitet *"Shërbimi i Dentistrisë në shkollat në periferi të Tiranës"*, raportuar më datë 16.3.2023 dhe datë zhvillimi 20.3.2023.
 - Aktivitet *"Vizitë në qendër shëndetësore Tiranë"*, raportuar më datë 16.3.2023 dhe datë zhvillimi 20.3.2023.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet email-it të datës 17.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *"Ministria e Shëndetësisë është e angazhuar maksimalisht për raportimin në kohë dhe shterues të të gjitha aktiviteteve me karakter publik në përputhje me nenin 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar si dhe Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Në lidhje me vonesën në raportimin e Aktivitetit "Inagurim të Spitalit të Sëmundjeve të Brendshme" raportuar në datë 15.3.2023, për t'u zhvilluar më datë 18.3.2023, sqarojmë se ky aktivitet është ripublikuar në ndërfaqen e KQZ për tu zhvilluar në datën 22.03.2023. Sa i përket dy aktiviteteve të tjera të sjella në vëmendje, raportuar në datë 16.3.2023 për tu zhvilluar në datë 20.3.2023, sqarojmë se keto aktivitete janë tentuar të publikohen që prej datës 14.03.2023 nga ana jonë, por ka qenë e pamundur për të aksesuar ndërfaqen e KQZ. Në këto kushte, në kuadër të detyrimit për të raportuar cdo aktivitet me karakter publik, aktivitetet e sipërpërmendura nuk janë raportuar në përputhje me afatet e përcaktuara."*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, konstaton se aktiviteti i parë me temë *"Inagurim i Spitalit të Sëmundjeve të Brendshme"* nuk është zhvilluar në datën e raportuar, por është ripublikuar për t'u zhvilluar në datën 22.3.2023. Vlerësojmë se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria e raportuar është raportuar brënda afatit ligjor.

Lidhur me dy aktivitetet e tjerë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pretendon se ka patur probleme me sistemin e ndërfaqes dhe nuk ka mundur të kryejë më herët raportimin.

Pavarësisht kësaj, sikundër parashikon neni 4 i vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në rastet kur institucioni e ka të pamundur teknikisht aksesimin e ndërfaqes, mund të dërgojë raportimin nëpërmjet email-it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar brenda afatit ligjor. Për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, tërheq vëmendjen Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që në vijim të kryejë raportimet duke respektuar afatin 5 (pesë) ditor të përcaktuar në ligj.

2. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Takim me biznesin për ndërgjegjësim për rritjen e pagave të punonjësve”*, raportuar më datë 13.3.2023 dhe datë zhvillimi 17.3.2023.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të depozituar pretendimet administrative, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, nëpërmjet shkresës të administruar nga KQZ me nr. 1786 prot., datë 21.3.2023, ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar se: *“Më datë 13.3.2023, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes parashikoi të ishte pjesëmarrës në takimin “Takim me biznesin për ndërgjegjësim për rritjen e pagave të punonjësve”. Ky takim u zhvillua me datë 17.3.2023, në ambientet e përbashkëta të Qendrës Tregtare “Toptani”, me folës kryesorë Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë dhe Ministrin e Financave dhe Ekonomisë. Në vijim dhe sipas koordinimit, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes znj. Bilali dhe asnjë përfaqësues i MSHMS nuk ishin pjesëmarrës në këtë takim. Në këtë konkluzion vlerësojmë se veprimtaria nuk cënon nenin 92 të Kodit Zgjedhor.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve, për atë që ka deklaruar në pretendimet e tij, konstaton se Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes nuk është organizator i veprimtarisë së raportuar. Gjithashtu rezulton që asnjë përfaqësues nga ky institucion nuk ka qenë i pranishëm në këtë aktivitet. Për sa më sipër, sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

3. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural-AZHBR ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 11 (njëmbëdhjetë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Informim lidhur me Aplikimet për Skemën Kombëtare, Durrës”*, raportuar më datë 13.3.2023 dhe datë zhvillimi 15.3.2023.

- Aktivitet “*Informim lidhur me Aplikimet për Skemën Kombëtare, Berat*”, raportuar më datë 13.3.2023 dhe datë zhvillimi 15.3.2023.
- Aktivitet “*Informim lidhur me Aplikimet për Skemën Kombëtare, Lezhë*”, raportuar më datë 13.3.2023 dhe datë zhvillimi 15.3.2023.
- Aktivitet “*Informim lidhur me Aplikimet për Skemën Kombëtare, Lushnjë*”, raportuar më datë 13.3.2023 dhe datë zhvillimi 16.3.2023.
- Aktivitet “*Informim lidhur me Aplikimet për Skemën Kombëtare, Vlorë*”, raportuar më datë 13.3.2023 dhe datë zhvillimi 16.3.2023.
- Aktivitet “*Informim lidhur me Aplikimet për Skemën Kombëtare, Shkodër*”, raportuar më datë 13.3.2023 dhe datë zhvillimi 16.3.2023.
- Aktivitet “*Informim lidhur me Aplikimet për Skemën Kombëtare, Elbasan*”, raportuar më datë 15.3.2023 dhe datë zhvillimi 16.3.2023.
- Aktivitet “*Informim lidhur me Aplikimet për Skemën Kombëtare, Kukës*”, raportuar më datë 15.3.2023 dhe datë zhvillimi 16.3.2023.
- Aktivitet “*Informim lidhur me Aplikimet për Skemën Kombëtare, Korçë*”, raportuar më datë 15.3.2023 dhe datë zhvillimi 16.3.2023.
- Aktivitet “*Informim lidhur me Aplikimet për Skemën Kombëtare, Gjirokastër*”, raportuar më datë 15.3.2023 dhe datë zhvillimi 17.3.2023.
- Aktivitet “*Informim lidhur me Aplikimet për Skemën Kombëtare, Dibër*”, raportuar më datë 15.3.2023 dhe datë zhvillimi 17.3.2023.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural-AZHBR nëpërmjet email-it të datës 20.3.2023, dhe nëpërmjet shkresave të administruara nga KQZ me nr. 1700 prot., datë 16.3.2023 dhe nr. 1754 prot., datë 17.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: “*Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në respektim të VKM nr. 125, datë 01.03.2023, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2023”, nisi procedurën me objekt “Informimi i publikut në lidhje me skemën kombëtare të mbështetjes në bujqësi për vitin 2023”, menjëherë me aktet administrative të përcaktimit të fondit limit ku vjen si rezultat i kërimit të tregut dhe ku ky proces kërkon afatin e vetë administrativ, konkretisht prej datës 1.3.2023, datë e cila mban VKM nr. 125, nga Komisioni i Hartimit të specifikimeve teknike janë hartuar specifikimet teknike të cilat mbajnë datën 3.3.2023, e në vijim të këtij procesi me shkresa zyrtare testimi i tregut për të arritur në fondin limit konkretisht më datë 6.3.2023. Me përcaktimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe fondin limit, Titullari i Institucionit në respektim të VKM nr. 1195, datë 5.8.2023, “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve , të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, në të cilën është përcaktuar qartësisht procedura që do të ndiqet dhe afatet kohore për çdo veprim administrativ, nga ana e Komisionit është hartuar ftesa për negociata publikuar në ëeb dhe dërguar Organet e Masm medias më datë 9.3.2023, me një afat*

Data: 5.4.2023 Nr: 268
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 10 Mars – 16 Mars 2023”

për të paraqitur dokumentacionin ligjor organet e medias më datë 13.3.2023. Pikërisht në datën e sipërcituar 13.3.2023 janë depozituar dokumentacionet nga Operatorët Ekonomik, ku në po të njëjtën datë është hartuar dhe miratuar raporti përmbledhës dhe Kontrata e Porosisë me nr. 896/7 prot., datë 13.3.2023. Lidhja e Kontratës së Porosisë më datë 13.3.2023, në respektim të VKM nr. 1195, datë 5.8.2023, “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, si dhe në respektim të afateve të përcaktuara në VKM nr. 1195, datë 5.8.2023, ka sjellë si pasojë publikimin në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike në KQZ aktivitetet me natyrë informuese, nga ana e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural. “Gjithashtu nëpërmjet shkresës ka pretenduar se personi përgjegjës i caktuar ka qenë në pritje të kredencialeve dhe si pasojë e mungesës së kredencialeve kemi dërguar me shkresë kalendarin e aktiviteteve të parashikuara për takimet me fermerët.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural–AZHBR, nëpërmjet pretendimeve të dërguara, ka provuar që nuk ka patur akses për të hyrë në ndërfaqen e raportimeve të KQZ–së, pavarësisht se nga administrata e KQZ–së i janë dërguar në kohë të dhënat përkatëse. Në këto kushte, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural–AZHBR ka dërguar raportimin e veprimtarive publike nëpërmjet shkresës që mban nr. 813/10 prot., datë 10.3.2023, protokolluar me tonën nr. 1700 prot., datë 16.3.2023. Neni 4 i vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, parashikon se, kur institucionet e kanë të pamundur teknikisht të aksesojnë ndërfaqen, mund ta dërgojnë raportimin nëpërmjet email-it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar. Për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative.

4. Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Panairi Food Expo 2023”, raportuar më datë 15.3.2023 dhe datë zhvillimi 18.3.2023.

Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve nëpërmjet email-it të datës 17.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: “Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), si institucion në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur pranë saj personin që do ishte përgjegjës për raportim në KQZ dhe më tej ka qenë Ministria e Financave dhe Ekonomisë që ka prapaqitur pranë KQZ personat përgjegjës për gjithë institucionet e saj të varësisë. Më tej KQZ duhet të vijonte me procesin e krijimit të aksesit të personit përgjegjës nga AIDA në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike në KQZ. Deri në datën 15.3.2023, nga KQZ nuk ishte realizuar hapja e këtij aksesit për AIDA, dhe mbi këtë

problematikë kemi qenë në komunikim me MFE. Sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 92, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, AIDA nuk ka patur asnjë aktivitet objekt raportimi për periudhën 4 muaj para zgjedhjeve. Për herë të parë në këtë periudhë, objekt raportimi ishte "Panairi Food Expo 2023" i cili zhvillohet në datën 18.3.2023. Për të raportuar në afatin ligjor 5 ditë para aktivitetit nevojitej aksesi në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike në KQZ. Ky akses është kërkuar nga AIDA pranë KQZ me anë të email-it në datë 13.3.2023. Ndërsa aksesi dhe kredencialet janë dhënë me anë të email-it të nisur nga KQZ në datë 15.3.2023. Për arsyen e shpjeguar më sipër, duke mos patur akses në ndërfaqe në kohën e duhur, AIDA ka raportuar menjëherë sapo kemi patur akses nga KQZ."

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstaton se aktiviteti "Panairi Food Expo 2023" është një ekspozitë, Panair Ndërkombëtar për sektorin e pijeve dhe ushqimeve që zhvillohet në Metropolitan Expo, Athinë, Greqi, në të cilën do të ketë më shumë se 1300 ekspozues grekë dhe të huaj të cilët do prezantojnë produktet e tyre dhe do realizojnë takime me kompanitë pjesëmarrëse. Nisur nga tematika dhe vendi ku zhvillohet veprimtaria, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk ka kompetencën të ndalojë zhvillimin e kësaj veprimtarie, për shkak se kryhet jashtë territorit shqiptar. Gjithashtu, mbështetur në të dhënat e përmbajtura në raportim, krijohet bindja se Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve ndodhet në cilësinë e të ftuarit në këtë aktivitet, dhe si e tillë nuk ka patur mundësi të raportojë. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

5. Prefekti i Qarkut Dibër ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet "Mbledhje e Organit Këshillues, Raportim mbi problemet e bujqësisë, masat e marra për përballimin e sezonit të ujitjes për verën 2023 (investimet e kryera dhe që do të kryhen) krijimi dhe funksionimi i OAU-ve , etj.", raportuar më 15.3.2023 dhe datë zhvillimi 15.3.2023.
2. Aktivitet " Mbledhje e Organit Këshillues, Raportim mbi problemet e bujqësisë, masat e marra për përballimin e sezonit të ujitjes për verën 2023 (investimet e kryera dhe që do të kryhen), krijimi dhe funksionimi i OAU-ve, etj", raportuar më 15.3.2023 dhe datë zhvillimi 16.3.2023.

Prefekti i Qarkut Dibër nëpërmjet e-mail-it të datës 17.3.2023 dhe shkresës me nr. 365 prot., datë 20.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: "Mbledhja e raportuar më datë 16.3.2023 në planin e punës të muajit mars ka qenë e parashikuar në një datë tjetër atë të datës 28 mars 2023. Për shkak të ndryshimit të agjendës së titullarit ky takim u vendos (nga sekretari i pergjithshëm dhe miratimin e titullarit) të bëhej në një datë të mëparshme pra

Data: 5.4.2023 Nr: 268
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 10 Mars – 16 Mars 2023"

16.3.2023, por ndryshimi i axhendës nuk lejonte që afati i publikimit në ndërfaqe të raportohej 5 ditë para. Sqarojmë se dy publikimet bëjnë fjalë për të njëjtën mbledhje. Duke qenë në rrethanat e raportimit të mbledhjes jashtë afatit titullari vendosi që kjo mbledhje të mos organizohet duke e anuluar atë. Pra mbledhja nuk është mbajtur në datën e raportuar. PRA është anuluar.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, për sa informacion jepet në ndërfaqe, vlerëson se aktivitetet “Mbledhje e Organit Këshillues”, përbëjnë veprimtari administrative që lidhet me veprimtarinë funksionale të institucionit. Gjithashtu, referuar edhe pretendimeve të institucionit, rezulton që aktivitetet të jenë anuluar. Për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative.

6. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Promovimi i dokumentarit “Rikthimi”, raportuar në datë 13.3.2023 për t’u zhvilluar në datë 17.3.2023.

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, nëpërmjet email-it të datës 21.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: “Ftesa për vizitën në Prishtinë të Ministrit të Drejtësisë dhe Titullarit të institucionit tonë është realizuar gjatë vizitës së Ministres së Drejtësisë së qeverisë së Kosovës Znj. Albulena Haxhiu ditën e hënë në datë 13.3.2023 në Ministrinë e Drejtësisë në Tiranë, kjo vizitë është realizuar në kuadër të bashkëpunimit të qeverive reciproke. Në lidhje me vizitën e Ministres së Drejtësisë së Kosovës, Ministria e Drejtësisë ka publikuar në faqen e instagramit një përmbledhe të takimit duke theksuar dhe ftesën për kthimin e vizitës në Prishtinë. Në këto kushte dhe raportimi nga ana jonë për aktivitetin e zhvilluar në kuadër të promovimit të dokumentarit të realizuar nga institucioni ynë, është realizuar në momentin që jemi vënë në dijeni për realizimin e takimit. Për sa më sipër, shpresojmë në mirëkuptimin tuaj sa i takon arsyeve që kanë sjellë vonesën në raportim sa i takon respektimit të afatit 5 ditor para zhvillimit të aktivitetit.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këto aktivitete për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

7. Bashkia Korçë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 5 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet *“Ceremoni në kuadër të Kampionatit Kombëtar të Volejbollit”*, raportuar më datë 15.3.2023 për t’u zhvilluar në datë 17.3.2023.
2. Aktivitet *“Në nderim të festës kombëtare të “25 Marsit 1821” shkolla jopublike Omiros fton Kryetarin e Bashkisë Korçë të bëhet pjesë e shfaqjes festive që do të organizojnë.”*, raportuar më datë 15.3.2023 për t’u zhvilluar në datë 18.3.2023.
3. Aktivitet *“Inspektim në fshatin Mborje”*, raportuar në datë 16.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 20.3.2023.
4. Aktivitet *“Takim me banorë në fshatin Drenovë”*, raportuar në datë 16.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 20.3.2023.
5. Aktivitet *“Me rastin e 14 Marsit Kryetari i Bashkisë Korçë do të festojë së bashku me qytetarët Ditën e Verës”*, raportuar më datë 10.3.2023 për t’u zhvilluar në datë 14.3.2023.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të depozituar pretendimet administrative, Bashkia Korçë nuk ka paraqitur pretendime.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet konstaton se, për dy aktivitetet e para *“Ceremoni në kuadër të Kampionatit Kombëtar të Volejbollit” dhe “Në nderim të festës kombëtare të “25 Marsit 1821” shkolla jopublike Omiros fton Kryetarin e Bashkisë Korçë të bëhet pjesë e shfaqjes festive që do të organizojnë.”*, nga të dhënat e raportuara në ndërfaqe, Bashkia Korçë ndodhet në cilësinë e të ftuarit, dhe si e tillë nuk ka patur mundësi të raportojë. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Lidhur me tre aktivitetet e tjera, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet konstaton se, Bashkia Korçë ka raportuar jashtë afatit ligjor, pa asnjë shkak të justifikuar. Për këtë arsye, tërheq vëmendjen Bashkisë Korçë që në vijim të kryejë raportimet duke respektuar afatin 5 (pesë) ditor të përcaktuar në ligj.

8. Bashkia Bulqizë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Marrëveshje bashkëpunimi”*, raportuar më datë 13.3.2023 dhe datë zhvillimi 17.3.2023.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të depozituar pretendimet administrative, Bashkia Bulqizë nuk ka paraqitur pretendime.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se nga sa informacion jepet në raportimin e kryer në ndërfaqe dhe nga tematika e veprimtarisë “Marrëveshje bashkëpunimi”, nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka kjo veprimtari apo nëse hyn në kategorinë e veprimtarisë administrative, funksionale të institucionit.

9. Bashkia Kuçovë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Aktivitet festiv per ditën e verës”, raportuar më datë 10.3.2023 për t’u zhvilluar në datë 14.3.2023.

Bashkia Kuçovë, nëpërmjet email-it të datës 20.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Së pari, institucioni jonë ka pasur probleme për të raportuar në ndërfaqen e raportimit të aktiviteteve. Kemi tentuar disa herë për të raportuar këtë aktivitet, por ka qenë e pamundur teknikisht dhe për këtë shkak raportimi është kryer me e-mail në emailin: institucione@kqz.gov.al. Së dyti, duke qenë se kishim këtë problemin e raportimit, për të qenë korrekt me legjislacionin në fuqi Kryetari i Bashkisë nuk mbajti asnjë fjalë gjatë aktivitetit, por ishte thjesht një pjesëmarrës në aktivitet si mijra qytetarë të Bashkisë Kuçovë. Së treti, theksojmë se Kryetari i Bashkisë merr pjesë në aktivitete duke kryer detyrat funksionale që ua dikton fusha e përgjegjësiive e përcaktuar në ligje të veçanta si kryetar bashkie dhe jo si kandidat. Ai është kryetari në detyrë dhe jo kandidat i ndonjë force politike. Së katërti, në nenin 2 të pikës 10 të Vendimit nr. 9, datë 29.01.2022 parashikohet se “Në rast se komisioneri konstaton se Titullari i Insitucionit ka penguar raportimin sipas këtij vendimi, ka ndikuar apo ka urdhëruar që ai të raportohet me vonesë apo veprimtaria është zhvilluar pavarësisht ndalimit të bërë nga KQZ, titullari i institucionit dënohet me gjobë “Nga interpretimi literal i kësaj norme kuptohet që duhet të përmbushen dy kushte që titullari i një institucioni të dënohet me masë administratrive për raportim me vonesë: 1. Aktiviteti të jete raportuar përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Si provuam më sipër, aktiviteti është raportuar me vonesë për probleme teknike që nuk varen nga ne dhe nuk ishin aktivitetet tona. 2. Titullari i Insitucionit të ketë ndikuar apo ka urdhëruar që ai të raportohet me vonesë. Nuk ka asnjë provë që kryetari i Bashkisë ka ndikuar ose urdhëruar raportimin me vonesë.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstaton se Bashkia Kuçovë ka patur probleme me sistemin e ndërfaqes dhe nuk ka mundur të përmbushë afatin ligjor për raportimin e këtij aktiviteti. Në këto kushte, Bashkia Kuçovë ka raportuar nëpërmjet email-it në datë 10.3.2023, duke tejkalluar afatin me një ditë vonesë. Sipas nenit 4 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në rast se institucioni e ka të pamundur teknikisht aksesimin e ndërfaqes, mund të dërgojë raportimin nëpërmjet email-it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar brenda afatit ligjor. Megjithatë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton situatën e krijuar në këtë rast, duke mos sanksionuar Bashkinë Kuçovë dhe tërheq vëmendjen që në vijim të kryejë llogaritjen e afatit

5 ditor sipas nenit 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton shprehimisht se raportimi duhet të kryhet jo më vonë se 5 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

10. Bashkia Mat ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Takim me rininë me rastin e ditës së verës”*, raportuar më datë 10.3.2023 dhe datë zhvillimi 14.3.2023.
- Aktivitet *“Përfundim i ndërtimit të çezmës publike “Parku Geraldinë”, Njësia Administrative Burrel”*, raportuar më datë 16.3.2023 dhe datë zhvillimi 20.3.2023.

Bashkia Mat nëpërmjet emailit të datës 21.3.2023 ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Duke ju kërkuar ndjesë për raportimin e aktiviteteve jashtë afatit ligjor të përcaktuar, ju sqaroj se ,nga ana jonë ka pasur një keqinterpretim në llogaritjen e afateve sipas nenit 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, pasi është bërë llogaritja e afateve duke filluar nga momenti i raportimit.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, krijoi bindjen se aktivitetet e raportuara me vonesë kanë ardhur si pasojë e interpretimit të gabuar të dispozitës ligjore të afatit 5 (pesë) ditor, duke përfshirë në llogaritje edhe ditën e zhvillimit të aktivitetit. Për këtë arsye, duke mirëkuptuar situatën e krijuar nga moskuptimi i drejtë i ligjit, tërheq vëmendjen Bashkisë Mat në vijim të kryejë llogaritjen e afatit 5 ditor sipas nenit 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton shprehimisht se raportimi duhet të kryhet jo më vonë se 5 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

11. Bashkia Pukë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Dorëzim titulli qytetar nderi, akorduar nga Këshilli Bashkiak të mjekut pukjan z. Musa Velaj”*, raportuar më datë 14.3.2023 dhe datë zhvillimi 18.3.2023.

Bashkia Pukë nëpërmjet email-it të datës 20.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se *“Ju kërkojmë ndjesë pasi kemi menduar se llogaritjet në 5 ditët e raportimit edhe dita e zhvillimit të tij. Duke ju kërkuar përsëri ndjesë, lapsusi në fjalë nuk do të përsëritet.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, krijoi bindjen se aktiviteti i raportuar me vonesë ka ardhur si pasojë e interpretimit të gabuar të dispozitës ligjore të afatit 5 (pesë) ditor, duke përfshirë në llogaritje edhe ditën e zhvillimit të aktivitetit. Për këtë arsye, duke mirëkuptuar situatën e krijuar nga moskuptimi i drejtë i ligjit, tërheq vëmendjen Bashkisë Pukë në vijim të kryejë llogaritjen e afatit 5 ditor sipas nenit 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton shprehimisht se raportimi duhet të kryhet jo më vonë se 5 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOS:

1. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
2. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:
 - a) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,
 - b) Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes,
 - c) Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural-AZHBR,
 - ç) Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve,
 - d) Prefekti i Qarkut Dibër,
 - dh) Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve,
 - e) Bashkia Korçë,
 - ë) Bashkia Bulqizë,
 - f) Bashkia Kuçovë,
 - g) Bashkia Mat,
 - gj) Bashkia Pukë,
3. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI